



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 155

16 shtator

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 44/2013, datë 14.9.2013	Për zgjedhjen e deputetit Edmond Spaho Zëvendëskryetar i Kuvendit	7071
Vendim i Kuvendit nr. 45/2013, datë 15.9.2013	Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave	7071
Vendim i KM nr. 761, datë 5.9.2013	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te komuna Vërtop, Berat, të sipërfaqes 12969 m ² , nga trualli funksional i pronës nr. 1029, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 5013”, Vërtop, Berat, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar	7072
Vendim i KM nr. 762, datë 5.9.2013	Për lejimin e komandës së forcës detare, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik, me objekt “Blerje naftë – F76”	7075
Vendim i KM nr. 764, datë 28.8.2013	Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Brendshme.	7075
Vendim i KM nr. 765, datë 5.9.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Shpëtim Saraçi.....	7076
Vendim i KM nr. 766, datë 5.9.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Gëzim Dibra.....	7076

Vendim i KM nr. 767, datë 5.9.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të fëmijës Omar Orges Begigi	7077
Vendim i KM nr. 768, datë 5.9.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të shtetases Oriana Nusha.....	7077
Vendim i KM nr. 769, datë 5.9.2013	Për lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për vazhdimin e procedurave të prokurimit për objektin “Mbrojtje nga lumi i Semanit i bregut dhe argjinaturës së krahut të majtë të rrjedhës në vendin e quajtur Gropa e Rrothes, Fier”.....	7078
Vendim i KM nr. 770, datë 5.9.2013	Për emërtimin “Bjeshkët e Bekuara”.....	7078
Vendim i KM nr. 771, datë 5.9.2013	Për dhënien në përdorim Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) të një pjese të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit.....	7079
Vendim i KM nr. 772, datë 5.9.2013	Për kalimin e përgjegjësisë, nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave te Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve, në Ministrinë e Financave, për kryerjen e procedurave të prokurimit të një pjese të fondit italian në mbështetje të projektit IPA 2010 “Forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për hartimin e akteve ligjore dhe zbatimin e legjislacionit të brendshëm për mjedisin”.....	7082
Vendim i KM nr. 774, datë 5.9.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 815, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme për Gardën e Republikës”.....	7082
Vendim i KM nr. 776, datë 5.9.2013	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.....	7087
Vendim i KM nr. 777, datë 5.9.2013	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.....	7087
Vendim i KM nr. 778, datë 5.9.2013	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të objektit “Poliambulanca” Shkodër, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Akademinë e Arteve Shkodër.....	7088
Vendim i KM nr. 779, datë 5.9.2013	Për lejimin e Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Mallakastër, si autoritet kontraktor, të vijoje kryerjen e procedurave të prokurimit për disa objekte.....	7090

Vendim i KM nr. 828, datë 5.9.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për financimin e Federatës Shqiptare të Alpinizmit për realizimin e aktivitetit në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë “Everest 2012”	7090
Urdhër i MD nr. 367, datë 6.9.2013	Për përcaktimin e rregullave mbi veprimet e kancelarit në rastin e konfirmimit apo arkivimit të urdhrit të ekzekutimit.....	7091
Vendim i KQZ nr. 791, datë 16.9.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike në qarkun Lezhë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	7093

VENDIM
Nr. 44/2013

PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETIT EDMOND SPAHO ZËVENDËSKRYETAR I KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, si dhe neneve 8, pika 2 dhe 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, si parti më e madhe e opozitës parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Deputeti Edmond Spaho zgjidhet në detyrën e Zëvendëskryetarit të Kuvendit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 14.9.2013

VENDIM
Nr. 45/2013

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES DHE PROGRAMIT POLITIK
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të neneve 96, 97, 98 dhe 78 të Kushtetutës, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8304, datë 11.9.2013 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet përbërja e Këshillit të Ministrave, si më poshtë:
- | | |
|-----------------------------|---|
| 1. Zoti Edi Rama | Kryeministër |
| 2. Zoti Niko Peleshi | Zëvendëskryeministër |
| 3. Zoti Ditmir Bushati | Ministër i Punëve të Jashtme |
| 4. Zonja Mimi Kodheli | Ministre e Mbrojtjes |
| 5. Zoti Saimir Tahiri | Ministër i Punëve të Brendshme |
| 6. Zonja Klajda Gjoshaj | Ministre e Integrimit Evropian |
| 7. Zoti Shkëlqim Cani | Ministër i Financave |
| 8. Zoti Edmond Haxhinasto | Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës |
| 9. Zonja Eglantina Gjermeni | Ministre e Zhvillimit Urban dhe Turizmit |
| 10. Zoti Arben Ahmetaj | Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes |
| 11. Zonja Lindita Nikolla | Ministre e Arsimit dhe Sportit |



12. Zoti Nasip Naço	Ministër i Drejtësisë
13. Zonja Mirela Kumburo Furxhi	Ministre e Kulturës
14. Zoti Erion Veliaj	Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
15. Zoti Damian Gjijnuri	Ministër i Energjisë dhe Industrisë
16. Zoti Edmond Panariti	Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
17. Zoti Ilir Beqaj	Ministër i Shëndetësisë
18. Zoti Lefter Koka	Ministër i Mjedisit
19. Zonja Milena Harito	Ministre Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike
20. Zoti Bledi Çuçi	Ministër Shteti për Çështjet Vendore
21. Zoti Ilirjan Celibashi	Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin

II. Miratohet Programi Politik i Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 15.9.2013

VENDIM
Nr. 761, datë 5.9.2013

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE KOMUNA VËRTOP, BERAT, TË SIPËRFAQES 12969 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR. 1029, ME EMËRTIM “ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5013”, VËRTOP, BERAT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te komuna Vërtop, Berat, të sipërfaqes 12 969 (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m², pjesë e pronës nr. 1029, me emërtim “Ish-Reparti Ushtarak nr. 5013”, me vendndodhje në Vërtop, Berat, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike në interes të komunitetit për ndërtimin e rrugës Ura e Vërtopit - fshati Drenovë.

2. Sipërfaqja 12 969 (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m², pjesë e pronës nr. 1029, me emërtim “Ish-Reparti Ushtarak nr. 5013”, me vendndodhje në Vërtop, Berat, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.


3. Komunës Vërtop i ndalohet të ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së përmendur në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Komuna Vërtop, në pjesën ku kufizohet rruga me repartin, pronë e Ministrisë së Mbrojtjes, të bëjë sistemimin e dherave nëpërmjet ndërtimit të mureve pritëse e mbajtëse, si dhe ndërtimin e gardhit rrethues të saj.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i komunës Vërtop për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 762, datë 5.9.2013

**PËR LEJIMIN E KOMANDËS SË FORCËS DETARE, SI AUTORITET KONTRAKTOR,
PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK, ME OBJEKT
“BLERJE NAFTE – F76”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013” dhe të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Komandës së Forcës Detare, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik, me objekt “Blerje nafte – F76”, me fond limit 28 105 560 (njëzet e tetë milionë e njëqind e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 764, datë 28.8.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT
TË VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Brendshme, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Policia e Shtetit”, artikulli 602 “Shpenzime për mallra e shërbime”, të shtohet fondi 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve ndaj detyrimeve kontraktuale të Policisë së Shtetit për transportin, ruajtjen dhe parkingun e mjeteve të bllokuara nga kjo strukturë, për të cilat arkëtimi i detyrimeve nga pronarët e mjeteve nuk është kryer brenda 3 (tre) muajve nga bllokimi.

b) Në programet “Planifikim-menaxhimi dhe administrimi” dhe “Garda e Republikës”, artikulli 602 “Shpenzime për mallra e shërbime” dhe 606 “Transferta për buxhete familjare dhe individë” të pakësohet fondi 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 765, datë 5.9.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
Z. SHPËTIM SARAÇI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 3 287 000 (tre milionë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Shpëtim Saraçi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 766, datë 5.9.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
Z. GËZIM DIBRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 8 170 000 lekë (tetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z. Gëzim Dibra.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 767, datë 5.9.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
FËMIJËS OMAR ORGES BEGIGI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 246 000 (një milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të fëmijës Omar Orges Begigi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 768, datë 5.9.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASES
ORIANA NUSHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të shtetases Oriana Nusha.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 769, datë 5.9.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
OBJEKTIN “MBROJTJE NGA LUMI I SEMANIT I BREGUT DHE ARGJINATURËS SË
KRAHUT TË MAJTË TË RRJEDHËS NË VENDIN E QUAJTUR GROPA E RRODHES,
FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 591, datë 15.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për vazhdimin e procedurave të prokurimit për objektin “Mbrojtje nga lumi i Semanit i bregut dhe argjinaturës së krahut të majtë të rrjedhës në vendin e quajtur Gropa e Rrothes, Fier”, me fondin limit 9 942 232 (nëntë milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë.

2. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 770, datë 5.9.2013

PËR EMËRTIMIN “BJESHKËT E BEKUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012, datë 28.6.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërtimin “Bjeshkët e Bekuara” të zonës me këto koordinata:

N 42 gradë 26’18.30;

N 42 gradë 24’59.52;

E 19 gradë 48’06.09.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 771, datë 5.9.2013

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR (ASIG) TË NJË PJESE TË GODINËS SË OBSERVATORIT TË
INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE DHE ENERGJISË, UJIT E MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Dhënie në përdorim Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) të ambienteve 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të katit të parë teknik të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit, sipas planimetrisë bashkëngjitur këtij vendimi.


2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit, që, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lirojnë mjediset përkatëse.

3. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha







VENDIM
Nr. 772, datë 5.9.2013

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË, NGA MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE, NË MINISTRINË E FINANCIVE, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT TË NJË PJESE TË FONDIT ITALIAN NË MBËSHTETJE TË PROJEKTIT IPA 2010 “FORCIMI I KAPACITETEVE TË MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE PËR HARTIMIN E AKTEVE LIGJORE DHE ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TË BRENDSHËM PËR MJEDISIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit IPA”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit të fondit prej 200 000 (dyqind mijë) eurosh, akorduar nga qeveria e Republikës së Italisë, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për mbrojtjen e mjedisit.
 2. Përgjegjësia e kryerjes së procedurave të prokurimit nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të kalojë te Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve, në Ministrinë e Financave.
 3. Procedurat e prokurimit të kryhen sipas rregullave të përcaktuara në udhëzuesin praktik për procedurat e kontraktimit të fondeve të Bashkimit Evropian (PRAG).
 4. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 774, datë 5.9.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 815, DATË 29.11.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME PËR GARDËN E REPUBLIKËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3, 10, 13 e 15 shkronja “a” të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në listën që i bashkëlidhet vendimit nr. 815, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave.

2. Heqjen nga lista e inventarit të pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, për Gardën e Republikës, të sipërfaqeve të pronës me emërtimin “Garda e Republikës, Garnizon”, të ndodhura në zonën kadastrale 8270, e përbërë nga pronat me numër pasurie 4/134 dhe pjesë e pasurisë 4/134, me sipërfaqe përkatësisht 2616 (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) m², 620 (gjashtëqind e njëzet) m², 3876 (tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m² dhe 442 (katërqind e dyzet e dy) m², gjithsej me sipërfaqe totale 7554 (shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) m², sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 29.8.2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", nr. 54, tel.: ++3554256831/35
PLANVENDOSJA E PRONËS




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", nr. 54, tel.: ++3554256831/35
PLANVENDOSJA E PRONËS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", nr. 54, tel.: ++3554256831/35
PLANVENDOSJA E PRONËS



VENDIM
Nr. 776, datë 5.9.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin buxhetor 06370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, zëri “Investime”, objekti “TVSH, projekti i kanalizimeve të Tiranës së madhe”, t’i zbritet fondi prej 107 000 000 (njëqind e shtatë milionë) lekësh.

2. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin buxhetor 04520 “Transporti rrugor”, t’i shtohet në zërin “Investime” fondi prej 107 000 000 (njëqind e shtatë milionë) lekësh, për financimin e punimeve të kryera dhe të pafinancuara në objektin “Rikonstruksion dhe zgjerim i Rrugës së Elbasanit, segmenti Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë - Unaza e Madhe e Tiranës”.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 777, datë 5.9.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE DHE MINISTRINË E
PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh ndërmjet ministrive në buxhetin e miratuar për vitin 2013, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin buxhetor 08140 “Zhvillimi i sportit”, në artikullin 231 “Investime”, t’i zbritet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh.



b) Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin buxhetor 04520 “Transporti rrugor”, t’i shtohet në zërin “Investime” fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh për financimin e punimeve të kryera dhe të pafinancuara në objektin “Rikonstruksion dhe zgjerim i Rrugës së Elbasanit, segmenti Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë - Unaza e Madhe e Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 778, datë 5.9.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË OBJEKTIT “POLIAMBULANCA”
SHKODËR, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS, PËR AKADEMINË E ARTEVE SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar dhe të nenit 82 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të objektit “Poliambulanca” Shkodër, me këto të dhëna: sipërfaqe totale objekti 1 770 (një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) m², sipërfaqe nën objekt 590 (pesëqind e nëntëdhjetë) m², sipërfaqe funksionale 631 m², sipërfaqe e përgjithshme 1 221 (një mijë e dyqind e njëzet e një) m², nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Akademinë e Arteve Shkodër, sipas planimeve dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Akademisë së Arteve Shkodër t’i kalojë trualli dhe ndërtesa që janë pronë shtetërore.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë dhe Akademia e Arteve Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha





VENDIM
Nr. 779, datë 5.9.2013

PËR LEJIMIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE SHA MALLAKASTËR, SI AUTORITET KONTRAKTOR, TË VIJOJË KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR DISA OBJEKTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013” dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ujësjiellës-Kanalizimeve sh.a. Mallakastër, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt: “Ndërtim depoje uji $V=1000\text{ m}^3$, për qytetin e Ballshit” dhe “Supervizion punimesh për objektin ndërtim depoje uji $V=1000\text{ m}^3$, për qytetin e Ballshit”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Mallakastër për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 828, datë 5.9.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR FINANCIMIN E FEDERATËS SHQIPTARE TË ALPINIZMIT PËR REALIZIMIN E AKTIVITETIT NË KUADËR TË 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË “EVEREST 2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi prej 7 700 000 (shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekësh, për financimin e Federatës Shqiptare të Alpinizmit për realizimin e aktivitetit në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë “Everest 2012”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontigjencës i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr. 367, datë 6.9.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE MBI VEPRIMET E KANCELARIT NË RASTIN E
KONFIRMIMIT APO ARKIVIMIT TË URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 310/1, 466/1 dhe 511/1 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor.

2. Kancelari i gjykatës së shkallës së parë brenda 5 ditëve nga mbarimi i afatit të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, verifikon nëse është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit nga palët në proces.

3. Nëse për vendimin gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë, është paraqitur ankim në gjykatën e apelit, kancelari nuk kryen asnjë veprim mbi kopjen e urdhrit të ekzekutimit.

4. Nëse për vendimin gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë, nuk është paraqitur ankim në gjykatën e apelit, kancelari verifikon nëse në vendimin gjyqësor është bërë shënimi mbi datën se kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Nëse në vendimin gjyqësor është bërë shënimi mbi datën se kur vendimi ka marrë formë të prerë, kancelari brenda 5 ditëve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë konfirmon në kopjen e urdhrit të ekzekutimit, që shoqëron vendimin gjyqësor, sipas rregullave të mëposhtme:

- a) vendos shënimin “I EKZEKUTUESHËM NGA DATA ____ / ____ / ____”;
- b) vendos gjeneralitetet e tij;
- c) vendos funksionin e tij;
- d) vendos nënshkrimin e tij; si dhe
- dh) vulos me vulën e gjykatës.

Kopja që përmban shënimet e mësipërme merr numrin dhe datën përkatëse dhe konsiderohet urdhër ekzekutimi. Urdhri i ekzekutimit u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të Kodit të Procedurës Civile.

5. Nëse vendimi gjyqësor i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar në gjykatën e apelit dhe kjo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, kancelari brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit verifikon nëse në vendimin gjyqësor është bërë shënimi mbi lënien në fuqi nga gjykata e apelit dhe mbi datën se kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Nëse në vendimin gjyqësor është bërë shënimi mbi lënien në fuqi nga gjykata e apelit dhe datën se kur vendimi ka marrë formë të prerë, kancelari brenda 5 ditëve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë konfirmon në kopjen e urdhrit të ekzekutimit që shoqëron vendimin gjyqësor, sipas rregullave të mëposhtme:

- a) vendos shënimin “I EKZEKUTUESHËM NGA DATA ____ / ____ / ____”;
- b) vendos gjeneralitetet e tij;
- c) vendos funksionin e tij;
- d) vendos nënshkrimin e tij, si dhe
- dh) vulos me vulën e gjykatës.



Kopja që përmban shënimet e mësipërme merr numrin dhe datën përkatëse dhe konsiderohet urdhër i ekzekutimit. Urdhri i ekzekutimit u njoftohet palëve, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të Kodit të Procedurës Civile.

6. Vendimi i gjykatës së apelit, i cili ndryshon apo prish një vendim të gjykatës së shkallës së parë, për të cilin duhet të lëshohet urdhër ekzekutimi, sipas pjesë së katërt të këtij Kodi, shoqërohet në çdo rast me urdhrin e ekzekutimit, të nënshkruar nga kryetari i trupit gjykues që ka dhënë vendimin. Urdhri i ekzekutimit dorëzohet në sekretarinë gjyqësore dhe kancelari brenda 5 ditëve konfirmon në kopjen e urdhrin të ekzekutimit që shoqëron vendimin gjyqësor, sipas rregullave të mëposhtme:

- a) vendos shënimin “I EKZEKUTUESHËM NGA DATA ____/____/____”;
- b) vendos gjeneralitetet e tij;
- c) vendos funksionin e tij;
- d) vendos nënshkrimin e tij; si dhe
- dh) vulos me vulën e gjykatës.

Kopja që përmban shënimet e mësipërme merr numrin dhe datën përkatëse dhe konsiderohet urdhër ekzekutimi. Urdhri i ekzekutimit u njoftohet palëve, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të Kodit të Procedurës Civile.

7. Kancelari i gjykatës së apelit njëkohësisht me palët, për urdhrin e ekzekutimit sipas pikës 6 të këtij urdhri, njofton edhe gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ndryshuar apo të prishur. Kancelari i gjykatës së shkallës së parë brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, urdhëron arkivimin nëpërmjet një shënimi të posaçëm në kopjen e urdhrin të ekzekutimit, sipas rregullave të mëposhtme:

a) vendos shënimin “AKT I ARKIVUAR-NDRYSHUAR/PRISHUR ME VENDIMIN GJYQËSOR TË GJYKATËS SË APELIT _____, NR. ____ DATË ____”.

- b) vendos gjeneralitetet e tij;
- c) vendos funksionin e tij;
- d) vendos nënshkrimin e tij;
- dh) vendos datën e arkivimit; si dhe
- e) vulos me vulën e gjykatës.

8. Vetëm urdhri i ekzekutimit i konfirmuar nga kancelari sipas rregullave të parashikuara në këtë urdhër, bëhet i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor.

9. Ngarkohen kancelarët e gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit për zbatimin e këtij urdhri.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

**VENDIM
NR. 791, datë 16.9.2013**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE NË QARKUN LEZHË, PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.9.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi (Lleshi)	Kryetare
Hysen	Osmanaj	Anëtar
Klement	Zguri	Anëtar
Vera	Shtjefni	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

Objekt: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike në qarkun e Lezhës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Vasil Bicaj.

Kërkues: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza Ligjore: Neni 23 pika 1 germa “a” neni 164 pika 2 i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 6767 prot., datë 11.9.2012, drejtuar KQZ-së, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit z. Marbind Myftiu, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Vasil Bicaj, deputet i zonës zgjedhore qarku Lezhë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 35, datë 2.8.2013 “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicionëve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Lezhë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Lezhë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013 ka fituar 4 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun e Lezhës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Aldo Bumçi, me numër rendor 2 (dy) Gjovalin Kadeli, me numër rendor 3 (tre) Albina Deda, me numër rendor 4 (katër) Vasil Bicaj.

Me njoftimin e heqjes dorë nga mandati i deputetit të zotit Vasil Bicaj, KQZ-ja ka detyrimin ligjor të marrë vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën e kandidatëve të listës shumemërore regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Demokratike në qarkun Lezhë i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164 pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit vijues të listës së Partisë Demokratike në Zonën Zgjedhore qarku Lezhë.



KQZ-ja me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për punësim, mirëqenie dhe integritet” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore. Sipas vendimit të mësipërm lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Lezhë e miratuar nga KQZ-ja, ka këtë renditje: me numër rendor 1 (një) Aldo Bumçi, me numër rendor 2 (dy) Gjovalin Kadeli, me numër rendor 3 (tre) Albina Deda, me numër rendor 4 (katër) Vasil Bicaj.

Sipas listës shumemërore të Partisë Demokratike për qarkun Lezhë kandidati, i cili renditet me numër rendor 5 (pesë) është zoti Mhill Pjetër Fufi. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se personit, të cilit do t’i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e z. Vasil Bicaj është z. Mhill Pjetër Fufi, i cili renditet përkatësisht me numër rendor 5 (pesë).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23 pika 1 germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike qarku Lezhë, z. Mhill Pjetër Fufi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARE
Lefterije Luzi (Lleshi)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 16.9.2013
Doli nga shtypi më 16.9.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 32 lekë